

Pas lajmeve që qarkullojnë tashmë në median e shkruar dhe atë vizive në lidhje me njoftimin e bërë nga ARRSH që shoqëria Gjoka Konstruksion sh.a ka paraqitur të dhëna fiktive në përpjekje për të fituar tenderin për ndërtimin e tunelit të rrugës Kardhiq-Delvinë lot 7”, kemi përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë përballë publikut për të bërë deklarinimin si vijon:

Më datë 25.04.2019 Autoriteti Rrugor Shqiptar publikoi në website e Agjencisë së Prokurimeve Publike, njoftimin për procedurën e prokurimit me objekt **“Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë, Loti 7”**, për t’u zhvilluar me date 27.05.2019 , Ora 11:00.

ARRSh më datë 20.05.2019 ka bërë shtyrje të afatit të tenderit nëpërmjet publikimit të Shtojcës Nr 1, ku data e është caktuar 07.06.2019, ndërsa më datë 03.06.2019 ka publikuar Shtojcën Nr 2 duke hequr dhe ulur kategoritë e licencës në ndërtim dhe ndryshim të kriterit të dëshmisë së përvojës së ngjashme në projektim për dëshminë e së cilës është riformuluar kërkesa, ku **si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes**. Nëpërmjet Shtojcës nr 2, është shtyrë afati i tenderit në datën 17.06.2019.

Në tenderin e zhvilluar më datë 17.06.2019 Gjoka Konstruksion sh.a anëtare dhe përfaqësuese e bashkimit të shoqërive ka paraqitur dokumentacionin si dhe ofertën. Pjesëmarrës ishin 6 operatorë të ndryshëm. 5 operatore rezultojnë në formën e një bashkimi shoqërorish ndërsa 1 operator rezulton si ofertues i vetëm. Gjatë hapjes së ofertave, oferta jonë ishte në vend të parë me diferencë të dukshme me secilin nga operatorët e tjerë të lexuar nga KVO. Kemi kërkuar përgjatë 2 ditësh paisjen me procesverbalin e hapjes së ofertave, por në shkelje flagrante të ligjit nuk na u mundësua asnjëherë nga ARrSh.

Më datë 20.06.2019 ora 14:07 nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik jemi njoftuar mbi s’kualifikimin tonë si bashkim operatorësh ekonomik. I vetmi i kualifikuar ishte “Ircop” S.p.a Degë e shoqërisë së huaj me diferencë **prej 509,729,253.75 leke me ofertën tonë që ishte oferta më e ulët**.

**Për koincidencë “Ircop” S.p.a Degë e shoqërisë së huaj sipas QKB rezulton se datën e regjistrimit të degës së saj në Shqipëri e ka me date 09.05.2019 çfarë na bën të dyshojmë se shtyrjet e fatit të tenderit kanë qenë pikërisht për t’i dhënë kohë kësaj kompanie për të plotësuar kriteret dhe në objekt të veprimtarisë së saj sipas QKB është “Aktivitet në fushën e ndërtimit”. Pas verifikimit të Statutit të kësaj shoqërie kemi konstatuar se nuk është e licensuar në projektim ndaj kemi patur pikëpyetjet tona se si do ta siguronte projektimin e këtij objekti, dhe si e kish garantuar ARrSh se plotësonte kriteret e kualifikimit për projektimin, kur nga sistemi rezultonte të ishte operator i vetëm në këtë garë.**

**Në datë 26.06.2019 “GJOKA KONSTRUKSION”sh.a përfaqësuese e BOE, ka paraqitur ankesë pranë Autoritetit Kontraktor duke kundërshtuar arsyet e të dhëna në sistem mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve nga Autoriteti Kontraktor dhe kualifikimin e “Ircop” spa sic rezultonte nëpërmjet sistemit.**

Në datë 01.07.2019 Autoriteti kontraktor, na ka njoftuar se pas shqyrtimit të ankesës ka vendosur lënien në fuqi të skualifikimit.

Skualifikimi është ankimuar nga ne në Komisionin e Prokurimit Publik, i cili me Vendimin 510/2019 datë 01.08.2019 ka urdhëruar ARrSh të rregullojë shkeljen e kryer dhe të kualifikojë

kompaninë tonë. Vendimi i KPP, organ të cilin Ligji i prokurimit e ka përcaktuar si organin më të lartë për shqyrtimin e ankesave në fushën e prokurimit publik, i është dorëzuar palëve më datë 05.08.2019 me postë me detyrimin për zbatim brenda 10 ditëve nga ARrSh.

**Më datë 13.08.19 vetëm 2 ditë para skadimit të afatit për zbatimin e Vendimit të KPP, Drejtori i ARrSh nxjerr Urdhër për verifikim të zbatimit të punimeve të kontratës të dorëzuar si punë e ngjashme në këtë procedurë nga “Gjoka Konstruksion” sh.a. Këto punime në vlerësimin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk kanë qënë arsye skualifikimi dhe as janë ngritur në asnjë çast dyshime në lidhje me vërtetësinë e këtyre punimeve.**

Në datën 16.08.2019 ARrSh ka kërkuar rishikimin e Vendimit 510/2019 të KPP, kërkesë e cila nuk është pranuar me Vendimin 510/4/2019 datë 20.08.2019 të K.P.P, dhe ka lënë në fuqi Vendimin 510/2019, të detyrueshëm për zbatim nga Autoriteti Kontraktor.

Më datë 28.08.219, ora 11:55 ARrSh ka zbatuar Vendimin 510/2019 e K.P.P ne sistem, ndërsa ka vijuar që më datë 02.09.2019 K.V.O të kryejë rivlerësimin e procedurës dhe ka refuzuar ofertën tonë duke arsyetuar se pas shqyrtimit të ankesës nga operatori BOE “Ircop” S.p.a & “Sulova Ndërtim Prodhim” & “Vega” & “A&E Engineering” perfaqësuar nga shoqëria “Sulova Ndërtim Prodhim” sh.p.k lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik Gjoka Konstruksion sh.a, si dhe raportit të inspektimit të grupit të specialistëve të ngritur me urdhër të titullares së AK për inspektimin dhe verifikimin në terren të punëve të deklaruara të përfunduara nga Gjoka Konstruksion sh.a, rezulton se: **Dokumentacioni i paraqitur nga operatori Gjoka Konstruksion sh.a paraqet të dhëna të rreme e të pasakta.**

Situata ndryshon kur ofertuesi i kualifikuar “Ircop” spa sic rezultonte nëpërmjet sistemit tashmë rezulton të jetë një bashkim shoqërisht i përfaqësuar nga “Sulova Ndërtim Prodhim” sh.p.k.

**ARrSh ne paligjshmëri totale të procedurës më datë 02.09.2019 ka skualifikuar shoqërinë tonë duke pretenduar se dokumentacioni ynë për punë të ngjashme paraqet të dhëna të rreme e të pasakta për të shpallur fitues me cdo mjet dhe formë “Ircop” s.p.a Degë ne Shqipëri me 509,729,253.75 leke mbi oferten tonë. Si mundej “Ircop” S.p.a Degë në Shqipëri (përfaqësuesja e BOE “Sulova Ndërtim Prodhim” sh.p.k) të kishte informacion për punimet e kryera nga Gjoka Konstruksion sh.a në rrugën e Arbrit të paraqitura si dëshmi e eksperiencës së ngjashme, kur nuk është ka qënë palë në këtë kontratë dhe nuk ka akses në vepër?**

**ARrSh ka patur të gjithë mundësinë dhe hapësirën ligjore për verifikimin e të gjithë dokumentacionit të paraqitur, përfshi objektin e ngjashëm të paraqitur nga Gjoka Konstruksion sh.a që më datë 17.06.2019. Asnjë dyshim mbi punët e ngjashme si dokumentacion që mbart informacion të rreme nuk është parashtruar nga ARrSh deri me datë 13.07.2019 kur duhej të zbatonte vendimin e KPP për të shpallur fitues Gjoka Konstruksion sh.a dhe BOE.**

Drejtori i ARrSh Sonila Qato ka nxjerr Urdhërin Nr.192 date 13.08.2019 për verifikim të zbatimit të punimeve të kontratës të dorëzuar si eksperiencë e ngjashme nga Gjoka Konstruksion sh.a. Ky urdhër nuk është komunikuar në kohë ndërkohe që inspektimi nga grupi i punës është kryer respektivisht në datat 13.08.2019, 14.08.2019 dhe 15.08.2019 në shkelje të procedurave, joprofesionalisht dhe hajdutshe. Kemi paraqitur dyshimin e arsyeshëm për përvojën profesionale të përfaqësuesve ne grupin e punës për inspektim, arkitekthe dhe juriste, të cilët kishin një moshë mestare 24

vjec dhe ne përputhje me ligjin, nuk plotësonin asnjë kriter për të pasur as licensa profesionale ne mbikqyrje dhe kolaudim punimesh për ndertime civile tunele, angazhim të cilin kishin marrë përsipër të realizonin. Nga verifikimi i punimeve në objekt Grupi i punës “me duar në xhepa” i cili ka inspektuar vetëm me sy të lirë, pa asnjë dokumentacion me vete në objektin që inspekton, pa projekt, situacion apo detaje teknike, pa marrë apo kërkuar asnjë mostër/kampion apo informacion nga ne dhe përfaqësuesi i Inxhinierit të Pavarur që i shoqëronte, ka dalë në konkluzionin se ka zëra punimesh, të cilat janë pasqyruar në situacionin përfundimtar si të përfunduara, por që në fakt janë të porealizuara dhe punimet në tunele vijoje akoma. Rezulton se me datë 19.08.2019 Drejtori i ARrSh Sonila Qato ka nxjerr Urdhërin Nr.192/1 date 19.08.2019 pasi përbërja e Grupit të parë linte për të dëshiruar, dhe ky fakt i ishte bërë më dije zyrtarisht nga ne. Nga dokumentat zyrtare të ARrSh të dala dhe botuar në shtyp rezulton sipas Raportit nr2, nr 7760/1 prot, datë 22.08.2019 se konkluzioni i përfshirë ne formularin e vlerësimit të lëshuar për nënkontraktorin Gjoka Konstruksion sh.a, situacioni përfundimtar dhe akt kolaudimi përmbajnë të dhëna fiktive, jo reale dhe që në fakt nuk përputhen me realitetin , me zërat dhe volumet reale të punimeve të kryera në terren deri në datën e inspektimit. **Për ironi të fatit edhe ky Grup pune ka inspektuar në të njëjtën formë si grupi i parë (arkitekte e juste): vetëm me sy të lirë, pa asnjë dokumentacion me vete në objektin që inspektojn, pa projekt, situacion apo detaje teknike, pa marrë apo kërkuar asnjë mostër/kampion apo informacion nga ne apo përfaqësuesi i Inxhinierit të Pavarur.** Asnjë konkluzion në lidhje me inspektimin e kryer nga të dyja grupet e punës, asnjë konstatim mbi shkelje të gjetura dhe vërejtje nuk na është dhënë nga ARrSh. Pas këtij raporti ARrSh ka vijuar të zbatojë Vendimin e KPP për shpalljen fitues më datë 28.08.2019 dhe cudia vazhdon pasi nese Arrsh kishte konstatuar dokumentacion te rreme si mund te na kualifikonte.

ARrSh nuk na ka njoftuar asnjë rezultat nga inspektimi i kryer duke bërë të pamundur që të japim mendimet, shpjegimet, komentet apo parashtrimet tona.

ARrSh rezulton të ketë qënë më e interesuar që gjetjet e saj ti ndaje me publikun dhe jo me ne si palë legjitime e cila preket direkt në këtë proces.

Në lidhje me gjithë pretendimet e ARrSh të publikuara në media sqarojmë opinionin publik se sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ARrSh-së në procedurën e tenderimit për plotësimin e kriterit të objektit të ngjashëm, janë përfunduar plotësisht 100% vetëm punime të situacionuara dhe të dorëzuara. Punimet në objekt vazhdojnë, vazhdojnë zëra punimesh të tjerë të zbatohen. Gjoka Konstruksion sh.a nuk është shprehur në asnjë pjesë të dokumentacionit të saj se **tunelet dhe Rruga e Arbrit kanë përfunduar plotësisht.** Është kryer kolaudim i punimeve të situacionuara dhe të realizuara nga Gjoka Konstruksion si nënkontraktor. Kontrata koncensionare e Rrugës së Arbrit e lidhur me Ministrinë e Infrastukturës dhe Energjisë, zbatimi i së cilës monitorohet nga Njësia e Zbatimit të Projektit të Rrugës së Arbrit dhe Inxhinieri i Pavarur-mbikëqyrës i punimeve të Rrugës së Arbrit, nuk ka përfunduar, por Gjoka Konstruksion nuk ka deklaruar kontratën koncensionare si objekt të përfunduar dhe është në nderin e drejtorit të ARrSh të mos abuzoj mbi këto fakte.

**Tunelet nuk janë deklaruar asnjë moment si të shfrytëzueshëm nga ne, deklarimi i tunelit si i shfrytëzueshëm do të behët nga Autoriteti kontraktor MIE dhe shoqëria koncensionare në përputhje të plotë me dispozitat e kontratës koncensionare dhe legjislacionin në fuqi.**

Cdo aludim mbi dokumentacionin e tillë si Formular Vleresimi, Situacion përfundimtar punimesh dhe Akt kolaudimi të paraqitur në tender nga **Gjoka Konstruksion sha, i cili paraqet të dhëna të rreme e të pasakta është i pavërtetë, i njëanshëm, i mbajtur nga një rrez besnik të zj Qato, të cilët me devotshmëri dhe pa profesionalizëm i kanë shërbyer drejtorit të ARrSh duke hedhur baltë mbi ne si shoqëri për qëllimin e vetëm, kualifikimin e një ofertuesi të regjistruar 1 muaj përpara shpalljes së tenderit me ofertë mbi 500 milion lekë më të lartë.**

Gjithashtu per sa i perket lajmit qe ne kemi marre 70 miliarde leke nga buxheti per pune qe nuk paskemi bere, duam te ju informojme qe eshte e pavertete. Deri me sot jane realizuar rreth 43 % te volumeve te punimeve qe do te thote qe jemi mbi 13 % para kohe ne realizim. E vetmja pagese qe kemi marre nga buxheti eshte ne fillim te vitit pasi kishim realizuar 25% te punimeve sipas parashikimeve ne kontrate. **Kjo pagese nga buxheti eshte 2.1 miliarde leke nga te cilat deri me sot i kemi kthyer shtetit pothuajse te gjithë kete shume ne pagesa tvsh dhe tatim fitimi.**

**Nga neseser padia e pare per drejtoreshen e arrsh do te jete fillimisht ne gjykate per prishje te imazhit te kompanise me informacione te nxjerra ne media te cilat jane te paverteta.**

Faleminderit,